

# Buletini Mjedisor

## MINISTRI I MJEDISIT TAKOHET ME HOMOLOGUN SLOVEN - NË FOKUS PYJET



Ministri i Mjedisit z. Lefter Koka, mori pjesë në "Takimin e 1-rë të Nivelit të Lartë të Mekanizmit Koordinues për Bashkëpunim në Fushën e Pylltarisë ndërmjet Kinës dhe Vendeve të Evropës Lindore dhe Qëndrore", i cili u zhvillua në Brdo pri Kranju (Sloveni). Në këtë takim ministri Koka ishte i ftuar nga Ministri Sloven i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ushqimit, z. Dejan Židan.

Qëllimi i takimit ishte miratimi nga 16 vendet e Europës Lindore e Qëndrore i objektivave të Planit të Veprimit të Mekanizmit Bashkëpunues ndërmjet Kinës dhe Vendeve të Evropës Lindore dhe Qëndrore, në fushën e Pyjeve, si dhe në të njëjtën kohë u prezantua mekaniizmi bashkëpunues në vetvete.

Gjatë nënshkrimit të këtij plani, ministri Koka u shpreh: "Jam i bindur se bashkëpunimi dhe ekspertiza që do të ofrojë zyra e koordinimit në Sloveni do të jetë thelbësore për të garantuar suksesin e këtij bashkëpunimi në të gjitha nivelet, si dhe në

arritjen e të gjitha objektivave, si ato afatshkurtra dhe në objektivat afatgjatë". Shqipëria dhe 15 vende të tjera që nënshkruan planin, ranë dakort për mbështetje të bashkëpunimit në menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve, multi-funksionalitetit të tyre dhe mbrojtjes së ligatave dhe jetës së egër.

Gjatë këtij takimi, ministri Koka zhvilloi një takim bilateral me homologun sloven z. Dejan Židan. Ministri Koka e njohu Z. Židan me arritjet e qeverisë shqiptare në fushën e mjedisit, duke theksuar se në këto tre vite, Shqipëria ka shënuar progres të dukshëm në përafrimin e legjislacionit vendas me atë të BE-së, si dhe në reformat e masat e marra në mjedis.

Nga ana tjetër, ministri Koka vuri në dukje se rruga drejt rehabilitimit të dëmeve të së shkuarës në mjedis dhe zhvillimi i qëndrueshëm i tij është një sfidë, në përballjen me të cilën, Shqipëria ka nevojë për mbështetje konkrete të vendeve të përparura në sektorin e mjedisit, përfshirë këtu edhe Sloveninë.

Pasi vlerësoi maskimalisht punën dhe pasqyrën e ministrit Koka për arritjet e deritanishme në fushën e mjedisit, Ministri Židan, ofroi mbështetje plotë të Ministrisë që ai drejton në fushën e pyjeve me ekspertizën e Institutit të Pyjeve dhe Institutit Shkencor sloven, të njohur për përvojën dhe profesionalizmin e tyre në kërkim dhe zhvillim në Evropë.

Gjithashtu ministri Židan mori angazhim që brenda vitit 2016 qeveria slovene do të investojë në pyllëzime një fond prej 300.000 eurosh në Bashkinë e Kolonjës.

Palët shprehën kënaqësinë e tyre për angazhimin e Shqipërisë në krijimin e mekanizmit koordinues për bashkëpunim në fushën e pyjeve përmes qeverisë së Kinës dhe 16 vendeve të Evropës Lindore dhe Qëndrore. Ministri sloven u angazhua për mbështetje që Slovenia dhe zyra koordinuese, që do të ngrihet, do t'i ofrojë vendit tonë asistencë dhe bashkëpunim midis dy vendeve në fushën e pyjeve. Në takim palët ranë dakort edhe për thithjen e fondeve të përbashkëta nga Fondi i Ekonomisë së Gjellërt.

## FILLON PROÇESI I GRANTEVE KONKURUESE PËR PYJET DHE KULLOTAT



Ministria e Mjedisit prezantoi më 13 Mars 2016 hapjen e procedurave për dhënie e Grantëve Konkurese për Pyjet, Kullotat dhe Bujqësinë, si njëri nga komponentët e Projektit të Shërbimeve Mjedisore, financuar nga Banka Botërore.

Të pranishëm në këtë takim ishin Ministri i Mjedisit, z. Lefter Koka, Ministri i Bujqësisë, z. Edmond Panariti, dhe Përfaqësuesja e Përhershme e Bankës Botërore për Shqipërinë, znj. Tahseen Sayed, shoqata mjedisore dhe përfaqësues të pushtetit vendor.

Në fjalën përshëndetëse, Ministri i Mjedisit, z. Lefter Koka, falenderoi maksimalisht për ndihmën dhe mbështetjen e dhënë nga donatorët, si dhe theksoi se "Sektori i mjedisit dhe pyjeve në Shqipëri ndodhet në një situatë të rëndë për shkak të dëmit që i është bërë mjedisit ndër vite. Ky projekt sjell risi në sektorin e pyjeve dhe në shërbimet mjedisore. Gjithashtu, po përgatitet një terren i gatshëm për fondet që pritet të vijnë nga komuniteti Evropian në fushën e Bujqësisë dhe Mjedisit".

Projekti prej 23 milionë dollarësh konsiston në Regjistrimin e Pyjeve dhe Kullotave, duke siguruar atë që mund të konsiderohet si "Çertifikata e Pronësisë" për pyjet dhe kullotat.

"Në 2 vitet e para të projektit do të kemi në dorë kadastrën elektronike të pyjeve dhe kullotave. Pas këtyre 2 viteve dhe në vazhdim, më në fund do të mund të flasim me shifra konkrete dhe reale, sa sipërfaqe pyjesh kemi, ku janë dhe si është gjendja e tyre, duke i dhënë kështu fund amullisë dhe abuzimit me të dhënat

e sipërfaqeve pyjore dhe kullotave"- u shpreh ministri Koka, i cili shtoi se mbi këtë informacion të saktë do të vazhdohet me rigjenerimin e pyjeve shqiptare atje ku është më e domosdoshme.

Pjesë e projektit është edhe prezantimi i Pagesave për Shërbimet Mjedisore, krijimi i skemave të qarta financuese për uljen e degradimit të tokës dhe mbështetjen e zhvillimit të qëndrueshëm, si një koncept dhe praktikë e shërbimeve mjedisore që aplikohet në shumë vende të zhvilluara dhe veçanërisht atyre të BE-së. Për fermerët dhe shoqatat komunale të Përdorimit të Pyjeve dhe të Kullotave do të punohet me miniprojekte të fokusuara vetëm në agromjedis. Ky proces do të arrihet duke punuar shumë ngushtë me Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor Rural (AZHBR).

Një pjesë e investimit do të shkojë në përgatitjen e fermerëve për të aplikuar rreth projekteve që priten të vijnë nga komuniteti Evropian në fushën e Mjedisit dhe Bujqësisë. Falë këtij projekti do të arrihet forcimi i kapaciteteve të stafit të Drejtorive Rajonale të Shërbimit të Pyjeve, Seksionit të Drejtorisë së Pyjeve në rreth, AZHBR-së dhe organeve të tjera të përfshira në shërbime bujqësore dhe zgjerimit të pyjeve.

Në përfundim të fjalës së tij, Ministri i Mjedisit theksoi se sektori i pyjeve është më i prekuri nga masakra që njeriu i ka bërë natyrës. Për këtë arsye Ministria e Mjedisit ka fokusuar punën e saj në mbjelljen e fidanëve brenda mundësisë së buxhetit të qeverisë dhe donatorëve të huaj.

Ministri i Bujqësisë, Z. Panariti, u shpreh se zhvillimi ekonomik i qëndrueshëm duhet t'i nënshtrohet zhvillimit ekologjik. "Ministria e Bujqësisë do të monitorojë zbatimin e projektit për të parandaluar erozionin e tokave. Nuk mund të zhvillojmë bujqësinë pa respektuar kriterin mjedisor"- tha ai.

Sakaq znj. Tahseen Sayed, theksoi rëndësinë e këtij projekti duke u shprehur, se kjo është e para herë që Shqipërisë i jepet një grant kaq i madh vetëm për pyjet. "Reduktimi i varfërisë rurale dhe zhvillimi i burimeve natyrore, sidomos i burimeve pyjore është një prioritet i rëndësishëm i qeverisë. Sektori shqiptar i pyjeve ka një potencial shumë të madh për të mbështetur rritjen ekonomike kombëtare, punësimin në zonat rurale dhe ruajtjen e mjedisit", u shpreh znj. Sayed.

Komponenti i Grantëve konkurese për shtimin e pyjeve fillon zbatimin më 1 qershor 2016. Shuma në dispozicion të aplikantëve do të jetë rreth 4 milionë dollarë. Përfitues direkt potencialë janë 260 Shoqatat e Përdoruesve të Pyjeve dhe Kullotave, si dhe 200 individë pronarë pyjesh, përdorues tradicionalë dhe fermerë, ndërsa Ministria e Mjedisit do të mbështesë fuqimisht me ekspertizën teknike në fushën e pyjeve dhe kullotave.

Ky projekt është financuar nga Banka Botërore, qeveria suedeze dhe GEF; ai ka filluar aktivitetin e tij në janar 2015 me një kohëzgjatje 5-vjeçare. Falë këtij projekti madhor do të realizohet Inventari Kombëtar i Pyjeve dhe Regjistrimi i pyjeve dhe i kullotave në të gjithë sipërfaqen e Shqipërisë.

### NË KËTË NUMËR:

MINISTRI I MJEDISIT TAKOHET ME HOMOLOGUN SLOVEN - NË FOKUS PYJET—PQ 1

INSPEKTOHEN BASHKITË PËR MENAXHIMIN E MBETJEVE—PQ 2

FILLON EDICIONI I IV-TË I FESTIVALIT TË FILMIT MJEDISOR, NË SHQIPËRI PQ 2-3

NGA AKTIVITETET E ORGANIZATAVE MJEDISORE—PQ 5

"Misioni i Ministrisë së Mjedisit, është të hartojë dhe propozojë politika, strategji dhe plane veprimi për mbrojtjen e administrimin e mjedisit dhe pyjeve në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm, përmirësimin të cilësisë së jetës dhe të integritetit të vendit në Bashkimin Evropian. Përbushja e këtij misioni do të realizohet duke marrë pjesë, ndërmjet bashkëpunimit veprimtarë, të cilat çojnë në zhvillime e mirëqenie afatgjata, duke mbrojtur natyrën dhe sensibilizuar opinionin publik".

## FONDI PYJOR DHE KULLOSOR KALON NË PRONËSI TË BASHKIVË

Kalon në Parlament projektligji "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9385, datë 4.5.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", të ndryshuar, si dhe "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9693, datë 19.3.2007 "Për fondin kulloros", të ndryshuar si nisimë ligjore e disa deputetëve.

Ministri Koka gjatë seancës plenare, sqaroi se ky projektligji nuk është ligji i ri në vetvete, por amendim i dy ligjeve ekzistuese për të zgjidhur problemin ligjor të krijuar nga reforma e decentralizimit. Ai theksoi se këto amendime do t'i japin zgjidhjen menaxhimit dhe administrimit të fondit pyjor dhe kulloros publik, si pasuri kombëtare, me kalimin pranë Bashkive në masën 100%, ngritjen e Drejtorive të Shërbimit Pyjor pranë bashkive, si dhe kalimin e fondit nga buxheti i Ministrisë së Mjedisit, pranë bashkive, fond i dedikuar për rigenerimin dhe pyllëzimin e pyjeve.

Në vijim, Ministri Koka theksoi se, ligji i ri i pyjeve do të realizojë një reformim të thellë për të siguruar zhvillimin e qëndrueshëm të pyjeve, por ky projektligji është ende për shqyrtim në Komisionin Parlamentar. Ai siguroi se kontrolli në pyje në këto muaj vazhdon të jetë mjaft intensiv, duke konsideruar këtu edhe faktin që jemi nën regjimin e moratoriumit të pyjeve.

Projektligjet e fondit pyjor dhe atij kulloros, përcaktojnë detyrat dhe të drejtat e Ministrisë së Mjedisit dhe të bashkive në administrimin dhe mbrojtjen e kësaj pasurie, duke u bazuar në parimin e zhvillimit të qëndrueshëm, të pasqyruar në dokumentet strategjike dhe angazhimet në kuadrin e konventave, marrëveshjeve, protokolleve dhe traktateve ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë është palë.

Projektligjet riorganizojnë qeverisjen e fondit pyjor dhe

kulloros kombëtar. Ato ngarkojnë Ministrinë e Mjedisit me funksionin politikbërës, nëpërmjet hartimit të strategjisë në fushën e pyjeve dhe kullotave, planit të veprimit, akteve ligjore dhe nënligjore, miratimit të planeve të menaxhimit.

Sipas dy projektligjeve të miratuara funksionet menaxhuese të fondit pyjor dhe kulloros kombëtar i ngarkohen bashkive, ndërsa funksionet kontrolluese mbeten objekt i punës së inspektoriatit të policisë pyjore.

Fondi që përfshihet në territorin e zonave të mbrojtura mbetet në pronësi dhe menaxhim të Ministrisë përgjegjëse të pyjeve.

Këto dy amendime të ligjit të Pyjeve dhe ligjit të Kullosave hyjnë në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

## INSPEKTOHEN BASHKITË PËR MENAXHIMIN E MBETJEVE

Gjatë katër muajve të 2016, degët Rajonale të Inspektoriatit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve kanë inspektuar 61 bashki në vend.

Objekti i inspektimit ka qënë në tre drejtime: (i) inspektim strukturave dhe institucioneve të trajtimit të mbetjeve urbane në varësi të bashkive; (ii) inspektim operatorëve privatë të kontraktuar nga bashkitë për shërbimin e pastrimit; (iii) inspektim në venddepozitimet e mbetjeve urbane, ose në landfilllet e ndërhuara posaçërisht.

Pas punës intensive tre mujore në terren, për verifikimin e gjendjes në grumbullimin, depozitimin dhe përpunimin e mbetjeve urbane, ISHMP kontaktoi zyrtarisht me institucionet e Pushtetit Vendor dhe u la detyrat sipas përcaktimeve dhe detyrimeve të ligjit.

Në përfundim të këtij inspektimi për ISHMP-në rezultoi se për vitin 2015, është gjeneruar një sasi vjetore prej 2.641.498 tonë mbetje të ngurta shtëpiake dhe 206.306 tonë mbetje inerte.

Ndërkohë pas analizës së bërë dhe procesverbalëve që ISHMP ka dorëzuar pranë 61 bashkive, dhe në bazë të problematikës së identifikuar iu është kërkuar bashkive, që të marrin masa emergjente për sa më poshtë:

Së pari, të merren vendime për përmirësimin e situatës në venddepozitimet ekzistuese të njësisë administrative të varësisë.

Së dyti, për shkak të problematikës të vërejtur të bëhet ndërhyrje urgjente për ngritjen e venddepozitimeve të reja për rastet e konstatuara, kur ato kanë dalë jashtë funksionit, por edhe në rastet e mungesës së tyre në njësitë administrative. Rastet më flagrante janë konstatuar në bashkitë Ura Vajgurore dhe Gramsh, ku mungojnë venddepozitimet.

Së treti, është kërkuar të merren masa urgjente nga ndërmarjet e varësisë së bashkisë ose operatorët privatë të kontraktuar për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e venddepozitimeve.

Së katërti, është konstatuar se disa nga bashkitë nuk respektojnë ligjin për të çuar mbetjet në landfilllet e qarqeve.

Në përfundim të analizës së 61 bashkive në vend u është lënë afat nga ana e ISHMP-së për zgjidhjen e problematikave që ka shfaqur secila prej tyre. ISHMP rifillon fazën e dytë të kontrollit dhe inspektimit gjatë muajit qershor, për të verifikuar zbatimin e detyrimeve ligjore që u linden bashkive.

Megjithë problematikën e vërejtur, z. Ergys Agasi, Kryeinspektor, ISHMP, deklaroi se "situatata konkrete në vitin 2016 paraqitet dukshëm më pozitive se vitet e kaluara, ku ndikim ka

pasur dhe puna intensive e ISHMP-së, si dhe fushatave ndërgjegjëse ndërmarrë nga Ministria e Mjedisit".

Pavarësisht kësaj, ISHMP kërkon kujdes e vëmendje të vazhdueshme për heqjen e mbeturinave nga akset nacionale dhe zonat turistike, bazuar kjo dhe në miratimin e planit të masave përgatitore për sezonin turistik veror për vitin 2016 nga ana e qeverisë shqiptare.

Sjellim në vëmendje se ligji për menaxhimin e mbetjeve urbane ngarkon 61 bashkitë e vendit për administrimin dhe menaxhimin e tyre. Referuar gjendjes aktuale dhe përgjegjësi që jep legjislativi kërkohet veprimi dhe angazhimi serioz i pushtetit vendor.

ISHMP kërkon nga kryetarët e bashkive që si përgjegjës të drejtpërdrejtë të ngarkuar nga ligji për menaxhimin dhe administrimin e mbetjeve që krijohen brenda territorit të tyre administrativ, të jenë proaktivë në zgjidhjen e situatave akute dhe problematikave që kanë.

Sigurojmë opinionin publik, se ISHMP po monitoron hap pas hapi zbatimin e detyrave të lëna, me qëllim sigurimin e një mjedisi të pastër e shëndetshëm për qytetarët shqiptarë.

## FILLON EDICIONI I IV-TË I FESTIVALIT TË FILMIT MJEDISOR, NË SHQIPËRI



21 Maj 2016 - Filloi Festivali i Filmit Mjedor, në Shqipëri; - një traditë e nisur që në vitin 2013. Festivali, i cili bashkëorganizohet nga Delegacioni i Bashkimit Europian në Shqipëri dhe Ministria e Mjedisit, me mbështetjen e shoqatave të ndryshme mjedisore, synon të ndërthurë kinemanë me shqetësimet mjedisore, duke rritur ndërgjegjësimin qytetar për mbrojtjen e mjedisit. Në ceremoninë e hapjes së festivalit, në qytetin e Tiranës, ishin të pranishëm: ambasadorja e Delegacionit të BE-së në Tiranë, znj. Romana Vlahutin, zëvendësiministria e Mjedisit, znj. Olijana Ifi, ambasadorë të disa vendeve të Bashkimit Europian, si dhe përfaqësues të shoqatave të ndryshme mjedisore, kineastë, qytetarë dhe të rinj të kryeqytetit, që janë ndjekës të kinemasë mjedisore.

Gjatë fjalës së saj përshëndetëse, znj. Ifi u shpreh se misioni kryesor i festivalit të filmit mjedor është ndërgjegjësimi i njerëzve për të ruajtur natyrën dhe për t'u orientuar drejt zhvillimit të qëndrueshëm të saj.

"Filmat që do të shohim gjatë festivalit do të na ndihmojnë të gjithëve të bëhemi më të ndërgjegjshëm dhe të shohim si

mundemi të veprimë, qoftë si individë, qoftë të gjithë së bashku, për të mbrojtur mjedisin tonë", tha në fjalën e saj Kreu i Delegacionit të BE-së në Shqipëri, znj. Romana Vlahutin. "Mbrojtja e mjedisit duhet të marrë vëmendje më të madhe politike, si dhe burime të mjaftueshme", shtoi Vlahutin, duke theksuar se festivali është një mundësi për të mësuar më shumë mbi çështjet globale dhe lokale të mjedisit dhe mbi zgjidhjet e mundshme.

Iris Elezi, Presidente e Jurisë së Festivalit të Filmit Mjedor në Shqipëri 2016, gjatë përshëndetjes së saj prezantoi edhe jurinë, që ajo do të drejtoje. Anëtarët e jurisë së "Eko fashion show" janë: z.Taulant Bino, biolog; znj. Kristina Alvares, fotografë; z. Besart Likmetaj, gazetar i BIRN; znj. Irma Tako, nga shoqëria civile.

Në vijim të ceremonisë, u projektuan filmat e programuar për ditën e parë të festivalit dhe më pas u bë përirimi i ekspozitës: "Dritare e hapur në brigjet shqiptare".

Edicioni i IV i EFFA 2016 do të vijojë me filma dhe aktivitetet të ndryshme, deri më datën 5 qershor, që shënon Ditën

Botërore të Mjedisit. Gjatë këtij edicioni do të shfaqen 57 filma nga 29 vende të botës, një pjesë e të cilëve shfaqen si premiera botërore. Njëherësh me projektionet e filmave sipas kategorive, gjatë Festivalit të Filmit Mjedor (EFFA2016) do të zhvillohen edhe 5 forume me praninë e ekspertëve të huaj dhe shqiptarë.

Dy javët e shfaqjes së filmave mjedorë do të shoqërohen me seminare mbi biodiversitetin dhe ndryshimet klimatike, ku pritet të mbahen edhe aktivitetet e tjera si konkurse artistike, ekspozita fotografike dhe shfaqje e artit ekologjik.

Për konkurrentët do të shpërndahen katër çmime për filmat me metrazh të gjatë, ato me metrazh të shkurtër, filmat eksperimentalë dhe talentet e reja.

Këtë vit filmat do të shfaqen në tetë qytete: në Tiranë, Shkodër, Valbonë, Vlorë, Përmet, Gjirokastrë, Skrapar dhe Ersekë. Shfaqja do të bëhet në ambiente publike me qëllim realizimin e misionit të festivalit: ndërgjegjësimin e publikut për mbrojtjen e mjedisit.

## MINISTRI KOKA PËRSHËNDET EDICIONIN E IV-TË TË FESTIVALIT TË FILMIT MJEDISOR NË SHQIPËRI

Të dashur miq,

Për të katërtin vit radhazi Shqipëria bëhet vendtakimi i kineastëve të përkushtuar ndaj mjedisit. Artistë nga vendi dhe bota sjellin në Festivalin e Filmit Mjedisor, fokusin e tyre ndaj mjedisit duke shkrirë kufijtë politikë dhe socialë, ashtu si edhe vetë mjedisi është. Me krijimet e tyre, ata jo vetëm që sjellin një realizim të bukur artistik, por edhe këndvështrimet dhe problematikat mbi realitete të ndryshme mjedisore.

Me ndjeshmërinë e tyre këta artistë synojnë që të ndikojnë në ndërgjegjësimin e publikut, institucioneve dhe organizatave që punojnë në fushën e mbrojtjes së mjedisit. Konstatoj me kënaqësi se këtë vit Festivali i Filmit Mjedisor ka zgjeruar spektrin e aktiviteteve përtej projeksioneve të filmave. Edicion pas edicioni

janë shtuar forumet mjedisore me ekspertë shqiptarë dhe të huaj, si edhe sesione të ndryshme informuese për publikun e të gjitha moshave.

Forumet e këtij viti, ndër të tjera, sjellin në vëmendje rolin e grave në mjedis, raportin e mjedisit me shëndetin e njerëzve, biodiversitetin dhe ndryshimet klimatike. Ato janë një mundësi e çmuar për të bashkuar zërin e ekspertëve më të mirë dhe të shoqërisë civile në misionin e përbashkët ndaj mjedisit.

Jam i gëzuar që pas dekadash harrese mjedisi është vënë ndër prioritet kryesore të politikës shqiptare, duke sjellë përparime të dukshme drejt zhvillimit të qëndrueshëm të tij, si dhe sfidave globale mjedisore me të cilat Shqipëria përballet.

Njëherësh është rritur ndjeshëm ndërgjegjësimi i shoqërisë shqiptare, ashtu sikurse edhe vëmendja mediatike ndaj çdo realiteti mjedisor në vendin tonë.

Këtë ndjeshmëri që Festivali i Filmit Mjedisor e thekson në çdo aktivitet të tij, ju ftoj që ta bëni pjesë të jetës suaj të përditshme, duke ju kujtuar se mjedisi nuk është një element i jetës, por është vetë burimi i saj.

Si i tillë duhet ruajtur me përkushtim dhe përgjegjësinë maksimale për ta trashëguar tek brezat e ardhshëm!

Lefter Koka

*Ministër i Mjedisit*

## AMBASADORJA E BE-SË NË TIRANË VLAHUTIN PËRSHËNDET EDICIONIN E IV-TË TË FESTIVALIT TË FILMIT MJEDISOR NË SHQIPËRI

Të dashur qytetarë,

Jam e lumtur t'ju paraqes Festivalin e katërt të Filmit Mjedisor në Shqipëri që zhvillohet nga 22 maji deri më 5 qershor 2016.

Cilësia e jetës dhe e të ardhmes tonë varet nga mundësia jonë për të ruajtur mjedisin, ajrin, ujin dhe pyjet. Kjo është një sfidë botërore. Mbrojtja dhe promovimi i mjedisit dhe zvogëlimi i ndryshimeve të klimës nuk është më një zgjedhje.

Ajo që është në rrezik është mbijetesa jonë midis shumë gjallesave të tjera. Bashkimi Evropian mban botërisht rolin udhëheqës në trajtimin e mbrojtjes së mjedisit, veprimeve mbi ndryshimet e klimës, efikasitetin e energjisë, rritjen e ndërgjegjësimit si dhe promovimin e konsultimeve publike.

Këtu në Shqipëri, në Ballkanin Perëndimor dhe në të gjithë botën, një mjedis i sigurt mund të përmirësojë cilësinë e jetës, shëndetin, prodhueshmërinë dhe ekonominë tonë. Festivali Mjedisor ofron një mundësi

të shkëlqyer për të dëshmuar problemet botërore dhe ato vendore të mjedisit dhe për të parë e për të menduar se si gjenden zgjidhjet dhe se si trajtohen sfidat.

Që prej Festivalit të parë në vitin 2013, ndërgjegjësimi mbi mjedisin në Shqipëri është përmirësuar dhe nxitur në masë të madhe. Ashtu si dhe në vitet e mëparshme, Festivali ofron kohë dhe hapësirë për prodhuesit e filmave nga i gjithë Ballkani e më gjerë për të treguar punën e tyre.

Më shumë se 70 filma janë përzgjedhur nga rreth 40 vende. Jam veçanërisht krenarë që ka shumë të rinj shqiptarë të përfshirë në krijimin e filmave dhe filmave vizatimorë. Në këtë program do të gjeni të gjitha aktivitetet që do zhvillohen këtë vit.

(<https://effalbania.files.wordpress.com/2016/04/effa-catalog-shqip1.pdf>)

Ashtu si dhe në festivalet e mëparshme, ato janë të hapura e falas për të gjithë.

Festivali do të organizohet në 8 qytete: Shkodër, Tiranë, Vlorë, Skrapar, Përmet, Ersekë, Gjirokastrë dhe Bajram Curri.

Në të përfshihen shfaqje përgjatë paraditeve për shkollat, si dhe shfaqje në zona të hapura përgjatë mbrëmjeve. Pesë konferenca do të prezantojnë praktikant më të mira të Bashimit Evropian dhe ato të vetë shqiptarëve në drejtim të ndërgjegjësimit për mjedisin.

Unë besoj se ky Festival i radhës do të ndihmojë që të ofrojë ide se si secili prej nesh mund të kontribuojë për një mjedis më të mirë, si këtu në Shqipëri ashtu dhe nëpër botë, dhe në këtë mënyrë të marrim pjesë në ndërtimin e një të ardhmeje të qëndrueshme për të gjithë ne dhe për brezat që vijnë.

Ju uroj shikim të këndshëm!

*Znj. Romana Vlahutin*

## SLLOVENI: MINISTRI KOKA TAKIM ME MINISTRIN KINEZ TË PYJEVE Z. JIANLONG



Në kuadër të vizitës së tij në Slloveni, për takimin e nivelit të lartë për krijimin e "Mekanizmit koordinues për bashkëpunim në fushën e pyjeve përmes qeverisë së Kinës dhe 16 vendeve të Evropës Lindore dhe Qendrore" zhvilloi një takim me Ministrin e Administrimit të Pyjeve z. Zhang Jianlong, Republika Popullore e Kinës.

Ministri Koka e njohu nga afër Z. Jianlong me zhvillimet më të fundit të vendit tonë në

sektorin e pyjeve, si dhe reformat e nismat, që Ministria e Mjedisit po ndërmerr për të siguruar zhvillimin e qëndrueshëm të pyjeve.

Ministri Koka vlerësoi maksimalisht qeverinë kinezë për këtë nismë madhore në kuadër të pylltarisë që ajo po ndërmerr në 16 vendet e Evropës Lindore dhe Qendrore dhe e siguroi për angazhimi konkret dhe proaktiv që Shqipëria do të ketë.

Gjatë takimit ai vuri në dukje dhe mbështetjen konkrete dhe të drejtëpërdrejtë që Shqipëria kërkon nga Kina veçanërisht në sektorin e pyjeve.

Ministri kinez i Administrimit të Pyjeve, z. Jianlong, u shpreh i gatshëm për intensifikimin e bashkëpunimit në fushën e pylltarisë mes 2 vendeve tona, si dhe ftoi Ministrin Koka për një vizitë zyrtare në Kinë.

Palët shprehën kënaqësinë e tyre për angazhimin e dakortësimin e Shqipërisë në krijimin e mekanizmit koordinues për bashkëpunim në fushën e pyjeve përmes qeverisë së Kinës dhe 16 vendeve të Evropës Lindore dhe Qendrore, si dhe vlerësuan marrëdhëniet mes 2 vendeve tona.

**VENDIMET E KOMISIONIT PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS 2016**

Nr.	Subjekti	Aktiviteti	Vendodhja	Hartoi Dosjen	Vendimi
1	Age Kuç	VP Hec	Kuç, Vlorë	Liljana Vllamasi	Plotësim Informacioni
2	Atean 846	VP Shfrytëzim kromi, galeri	Bulqizë, Dibër	Remzi Pupli	Plotësim Informacioni
3	Atean 847	VP Shfrytëzim kromi, galeri	Bulqizë, Dibër	Remzi Pupli	Plotësim Informacioni
4	Denim Factory	VP Fasoneri	Durrës	Brisilda Saraçi	Vendim për VNM Paraprake
5	Elit Gas	VP 5 depozita sipërfaqësore të gazit natyror	Shëngjin, Lezhë	Ilir Robo	Vendim për VNM Paraprake
6	Eurobiznes	VP Ndërtim Hidrocentrali 1,2 & 3 (2MË)	Kukës	Nikoll Marku	Vendim për vnm të thelluar
7	Hydropower panarit	VP Hidrocentrali Vile	Korçë	Ferdinand Kurteshi	Plotësim Informacioni
8	IMS group	VP Përpunim i peshkut & zorrëve të kafshëve (gjedh, derr, kal etj)	Lezhë	ECO	Vendim për VNM Paraprake
9	Loci	VP Godinë ndërtimi 8K+ 1K nëntokë	Fushë Krujë, Durrës	Arben Muha	Vendim për VNM Paraprake
10	Marlindi XH-2014	VTH Shfrytëzim Kromi	Kukës	Hysen Doci	Deklaratë Mjedisore
11	UENND	VP Rritje e shpendëve	Kavajë, Tiranë	LOERMA	Plotësim Informacioni

**GJIMNAZI "SAMI FRASHËRI" PJESE E PROJEKTIT 'QYTETARI SHKENCËTAR'**


Ditën e enjte datë 26.05.2016, Ministria e Mjedisit në bashkëpunim me projektin e UNDP-së 'EIMMS' dhe Kopshtin Botanik Tiranë zhvilloi një orë të hapur për biodiversitetin dhe speciet më të përhapura në zonën e Tiranës me nxënësit e klasave të 10-ta të shkollës së mesme të përgjithshme "Sami Frashëri" Tiranë.

Në këtë orë të hapur mesimorë u mbajt një prezantim mbi Programin Kombëtar të Edukimit Mjedisor dhe Konventën e Aarhusit, ku nxënësit u shpjegua vendi që duhet të zërë mjedisi jo vetëm në kurrikulat mesimorë, por dhe në jetën dhe sjelljen e tyre të përditshme, duke treguar kujdes të vazhdueshëm ndaj gjithçkaje që na rrethon.

Në shpjegimin mbi Konventën e Aarhusit u kushtua rëndësi njohtjes së parimeve të demokracisë mjedisore, që sanksionon kjo Konventë, të drejtat e nxënësit si qytetarë të këtij vendi dhe rrugët sesi ata duhet të ushtrojnë këto të drejta për të

njohtur mjedisin dhe për t'u bërë pjesë e e vendimeve me ndikim në mjedis, që ndërmarrin drejtuesit e qytetit të tyre.

Një tjetër prezantim ishte për gjendjen e përgjithshme të biodiversitetit në Shqipëri, pasuria e florës dhe faunës në vendin tonë. Gjithashtu, një vend i veçantë iu kushtua edhe kategorizimit të zonave të mbrojtura dhe nivelit të mbrojtjes që tregohet për këto zona sipas kategorizimit.

Prezantimi i tretë u bë nga znj. Odeta Çato, Kordinatore e Projektit UNDP-EIMMS, ku u prezantua koncepti "Qytetari Shkencëtar", si pjesë e aktivitetit BioBlitz, të organizuar nga *National Geographic* dhe që ka për synim të katalogojë speciet e ndryshme që gjenden në mbarë globin nga qytetarë që foto-grafojnë specie të ndryshme dhe i ngarkojnë ato në portalin INaturalist, duke saktësuar datën, llojin e speciet dhe gjeoreferencimin.

Në këtë projekt, klasa e përzgjedhur e kësaj shkolle është regjistruar në këtë portal dhe në ditët në vijim do të kryejë një


vizitë studimore në terren, tek Kopshti Botanik i Tiranës, ku pasi të kenë shkarkuar aplikacionin dhe të kenë mbledhur të dhëna për speciet që gjenden në këtë Kopsht, do të kontribuojnë me fotot e tyre në katalogimin e florës dhe faunës së Kopshtit Botanik Tiranë, si pjesë e portalit INaturalist.

Më pas, përfaqësuesja nga Kopshti Botanik, znj. Ermelinda Mahmutaj, zhvilloi një bashkëbisedim me nxënësit, si parapërgatitje për punën që ata do të bëjnë gjatë vizitës në terren, njohtjen me speciet më të përhapura në zonën e Tiranës, të cilat të rinjtë e kësaj klase do mund ti identifikojnë vetë gjatë vizitës studimore, që do të bëhet në datë 3 Qershor në kopshtin Botanik të Tiranës.

Më pas ora e hapur vijoi me shfaqjen e dokumentarit *Terra Incognita*, e prodhuar nga IUCN dhe pjesëmarrës në Festivalin e Filmit Mjedisor në Tiranë.

**VENDIMET E KOMISIONIT PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS 2016**

NR	Subjekti	Aktiviteti	Vendodhja	Hartoi Dosjen	Vendimi
1	Urban Garden Limited	VP Projekt rezidencial Tiranë Cielo	Tiranë	GEC Studio	Vendim për VNM Paraprake
2	"Trebeshina"	VP Nxjerrje uji	Gjrokaštër	"Studime projektive min-erare"	Plotësim Informacioni
3	SOLOMON	VP Ndërtim magazine për produkte bujqësore	Fier	Aleksandër Rukaj	Vendim për VNM Paraprake
4	Alesio 2014	VP Impiant asfalto - betoni	Tiranë	"ECA Studio"	Vendim për VNM Paraprake
5	Cikalleshi	VP Kapanon industriale 1K	Tiranë	Alban Uka	Vendim për VNM Paraprake
6	Alb Inert	VTH Karriere guri gelqeror dhe fraksionim inertesh	Velipojë, Shkodër	Studio Oskoloa	Plotësim Informacioni
7	Blue Eye Water	VP Prodhim uji	Vlorë	"Comercir"Sh.p.k	Vendim për VNM Paraprake
8	Autoriteti Rrugor Shqiptar	Ndërtim rruge	Elbasan	Studio G&K	Vendim për VNM Paraprake



“Kërcënimi më i madh që i kanoset planetit tonë është që çdo njëri nga ne beson se dikush tjetër do e shpëtojë atë”.

Robert Swan

SEKTORI I TRANSPARENCËS DHE KOMUNIKIMIT

Email: info@moe.gov.al

## NGA AKTIVITETET E ORGANIZATAVE MJEDISORE

### TA PASTROJMË SHQIPËRINË: AKSIONI I 6-TË KOMBËTAR "TA PASTROJMË SHQIPËRINË - 20 MAJ 2016



Green Line Albania që vepron prej 5 vitesh në Shqipëri, ka ndërmarrë aksionin kombëtar "Ta Pastrojmë Shqipërinë".

Ky është aksioni i gjashtë i organizuar nga Lëvizja "Ta Pastrojmë Shqipërinë" në të cilin numërohen 4 aksione në rang kombëtar dhe 2 aksione "Ta Pastrojmë Bregdetin". Realizimi i përgatitjes së këtyre aksioneve, gjithmonë në këto vite është shoqëruar me "Green Tour", i cili në një fushatë dy javore, ka shëtitur nëpër qytetet e Shqipërisë, duke kryer takime në nivele vullnetarësh dhe pushteti vendor, duke përçuar kështu frymën për një Shqipëri më të pastër.

Më 20 Maj, aksioni u hap zyrtarisht në fushën poshtë digës së Liqenit Artificial me pjesëmarrjen e:

Green Line Albania, Vullnetarë – Nxënësit të shkollave "Petro Nini Luarasi" dhe "Sami Frashëri" gjithashtu dhe me bashkëpunimin e Agjencinë e Zonave të Mbrojtura, Inspektoriatin Kombëtar të Mjedisit, me degën Ujësjellës Kanalizimeve Tiranë, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit, DPN 1, DPN 2, Njësia Administrative nr. 5. Me kompanitë private: AlbBuilding, Salilari, Fusha dhe Everest të cilët kontribuan me logjistikë të rëndë.

Sipas informacioneve, pjesëmarrja numërohet në mbi 100,000 vullnetarë. Gjatë gjithë ditës do të përpunohen të dhënat për të nxjerrë rezultatet përfundimtare të pjesëmarrjes dhe sasisë së mbetjeve të pastruara.

### 22 MAJ—DITA EUROPIANE E PARQEVE



Shoqata ALPIN—Për të gjithë njerëzit që prej shumë vitesh, 24 Maji na kujton ditën e Parqeve, ditë që u krijua në vitin 1999 në Suedi.

Në këtë ditë zhvillohen veprimtari të ndryshme në parqe dhe zonat e mbrojtura anembanë Europës, ku dashamirësit e natyrës festojnë së bashku si dhe kërkojnë prej të gjithëve vëmendje më shumë për këto oazet e natyrës. Ndaj shoqata Alpin në bashkëpunim me nxënësit e shkollës së mesme "Matosh Uka" Fierzë zhvilluan një ekspeditë në Parkun Kombëtar në Luginën e Valbonës. Gjatë kësaj vizite nxënësit eksploruan bukurinë, panoramën e turizmit rural, të kësaj zone magjepëse. Ata vëzhguan në terren, natyrën e egër dhe habitatet e tyre, po ashtu florën e shumëllojshme monumentet e natyrës, që parku ofron.

Kjo shoqatë nëpërmjet këtij aktiviteti të zhvilluar në Luginën e Valbonës bëri thirrje që çdo individ të qëndrojë më afër me natyrën.

Po ashtu, ata kërkonin të rrisnin ndërgjegjësimin e publikut mbi rëndësinë dhe bukuritë natyrore, të paraqesim vlerat dhe përfutimet që sjell për banorët, por dhe më gjerë, zonat e mbrojtura. Çdo kush që hy në park largohet me mbresa të mira, por dhe me dëshirën që herën tjetër problematikën që

parqet mbartin do të minimizohen.

Fëmijët u vunë përballë faktit që rreziku kryesor natyrës i vjen vetëm nga njeriu, i cili me veprimet e tij shkakton shpyllëzime, dëmtime dhe coptime habitatesh, ndotjen e ujit dhe Mjedisit; guctinë e pa kontrolluar, si dhe ndërtimet pa kritere që përbëjnë rreziqe potenciale për ekzistencën e parqeve dhe biodiversitetit që e popullon atë.

### KONGRESI KOMBËTAR I INDUSTRIËS SË BIMËVE MJEKSORE DHE AROMATIKE NË SHQIPËRI

MEDALB INSTITUT – Në 26 Maj u organizua në Tiranë, Kongresi Kombëtar i Industriës së Bimëve Mjeksores dhe Aromatike në Shqipëri me mbështetjen e zyrës USAID-it në Shqipëri.

Në këtë aktivitet morën pjesë dhe përshëndetën kongresin edhe përfaqësuesi i misionit të USAID në Shqipëri, z. Marcus Johnson, dhe Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, z. Edmond Panariti, të cilët evidentuan investimet, arritjet, sukseset, problematikat dhe mundësitë e mëdha që ka vendi jonë për zhvillimin me sukses të këtij sektori të rëndësishëm dhe rritjen e eksportit të bimëve mjekësore dhe aromatike.

Gjithashtu, në këtë kongres mori pjesë dhe diskutoi edhe Presidenti i Institutit të Bimëve Medicinale të Shqipërisë - "MedAlb Institut" z. Luan Ahmetaj.

Në fjalën e tij para të pranishmëve z. Ahmetaj nënvizoi rëndësinë dhe vlerat e mëdha mjekësore, mjedisore dhe ekonomike që kanë bimët mjekësore dhe aromatike, vlerat dhe shërbimet e mëdha të tyre në ekosistem, si pjesë mjaft e rëndësishme e biodiversitetit, si shfrytëzuese dhe mobiluese të tokave joproduktive dhe të eroduar, si lëndë e parë në industrinë mjekësore, farmaceutike dhe kulinare si dhe për vlerat e mëdha që ato kanë në punësimin e komunitetit të zonave rurale, në rritjen e të ardhurave të familjeve të tyre si dhe në kontributin, që ato japin në rritjen dhe fuqizimin e ekonomisë së vendit.

Gjithashtu z. Ahmetaj parashtrij rolën e madh që ka edukimi i aktorëve të zinxhirit të vlerave të bimëve mjekësore, monitorimi i vazhdueshëm i procesit të grumbullimit dhe të kultivimit të tyre si dhe certifikimi i cilësisë së produkteve dhe nënprodukteve që përfshihen prej tyre.

Në fund të diskutimit të tij z. Ahmetaj theksoi rolin përcaktues që kanë strukturat shtetërore: Së pari, në kryerjen e monitorimit të rritjes dhe përhapjes së bimëve mjekësore dhe aromatike, si edhe të sipërfaqeve që janë të mbjella me këto bimë, inventarizimi i llojeve dhe nënlojeve të këtyre bimëve që rriten në natyrë dhe që kultivohen në vendin tone, si dhe hartizimi dhe dixhitalizimi i të dhënave dhe statistikave.

Së dyti, ndërtimi dhe zbatimi i sistemit të gjurmëshmërisë së origjinës së produkteve dhe nënprodukteve që përfshihen nga

bimët mjekësore dhe aromatike në vendin tonë.

### RIKIKLO DHE TI



Shoqata JONA – Sarandë, së bashku me nxënësit dhe mësuesit e shkollës "9 Tetori", kanë nisur një projekt pilot për riciklimin e plastikës në qytetin e Sarandës. Ky projekt zhvillohet me mbështetjen e PPNEA-së në kuadër të projektit "Toka e Kështjellave dhe Shqiponjave" financuar nga CEPF. Përfaqësuesit e Shoqatës JONA dhe mësuesit e zonës, fillimisht kanë realizuar një fushatë të gjerë, informuese dhe ndërgjegjësuere mbi impaktet e plastikës në mjedis, dhe më tej kanë organizuar dhe zhvilluar nismën "Të Riciklojmë Plastikën për një Mjedis më të Pastër".

Kjo nismë fillimisht po zbatohet në shkollën "9 Tetori" në Sarandë, për t'u përhapur në tej në të gjitha shkollat e zonës. Tashmë shkolla "9 Tetori" për çdo javë zbaton "Ditën e Riciklimit", ku të gjithë nxënësit sjellin me vete plastikën e gjeneruar nga familjet e tyre.

Në të njëjtën ditë, një operator riciklimi në Sarandë, grumbullon plastikën kundrejt një pagese. Me të ardhurat e grumbulluara, nxënësit e kësaj shkolle, realizojnë investime të nevojshme për shkollën e tyre si dhe ekskursione studimore. Shpresojmë që institucionet përkatëse dhe grupe të tjera interesit, të frymëzohen nga kjo punë e shkëlqyer e mjedisoreve të Sarandës, dhe t'i mbështesin ata më tej në këtë nismë sa e vështirë në dukje aq edhe e realizueshme nëse ekziston pasioni për mjedisin. Kjo nismë, ndonëse në dukje e vogël, po zbaton të njëjtat parime me sistemet moderne të riciklimit në vendet e zhvilluara.

### RRJETI I INFORMIMIT I BE-SË NË SHQIPËRI



Shkodër - Në kuadër të Festivalit European të Filmit Mjedisor, gjatë sesionit të mëngjesit për fëmijë, GO2 diskutoi me nxënësit e klasës së VI-të të shkollës "Mati Logoreci" lidhur me Lëvizjen e Qëndrueshme Urbane (ndikimin pozitiv në cilësinë e jetës), si dhe elementin e barazisë gjinore në Kulturën e Bëçkiletës së qytetit të Shkodrës.

Mbas këtij takimi, nxënësete iu bë ftesë e hapur për pjesëmarrjen e tyre në aktivitetet e tjera, që GO2 ka parashikuar, për ndërgjegjësimin e komunitetit mbi çështjen e Lëvizjes Urbane, në vazhdimësi të projektit TEUTA-Toward EU with better Urban Transport.